



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**Tiranë më, 02.11.2021**

**Dokument parlamentar**

*(Komision për dhënie mendimi)*

**RAPORT**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

**I. HYRJE**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 3 nëntor 2021, shqyrtoi dhe miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, i cili është propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Për shqyrtimin e këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatorë deputetët z. Alqi Bllako dhe z. Klevis Xhoxhi.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin ishin znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë dhe z. Besart Kadia Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit dhe e Borxhit Publik dhe përfaqësues të tjerë të ministrisë.

Bazuar në vendimin e Konferencës së Kryetareve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

## **II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” është propozim i Këshillit të Ministrave dhe paraqitet për shqyrtim dhe miratim bazuar në nenet 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

## **III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT 2022**

Projektligji parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore si dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve) për vitin buxhetor 2022.

Objektivat madhorë të projektbuxhetit 2022 janë rimëkëmbja ekonomike, kjo në vazhden e përpjekjeve për t’i tejkaluar me sukses pasojat negative të dy fatkeqësive natyrore që goditën vendin tonë, pra tërmeti i 26 nëntorit dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19 dhe objektivi tjetër ai qëndrueshmërisë fiskale, i cili siguron qëndrueshmëri të financave publike për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, duke krijuar kështu baza të forta për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Projektbuxheti i vitit 2021 parashikon një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist për sa i përket rritjes ekonomike, deficitit buxhetor, borxhit publik dhe normës së papunësisë.

Rimëkëmbja ekonomike, bazohet në pritshmërinë pozitive të Qeverisë për një rritje ekonomike domethënëse në vitin 2021 prej 7.6%, duke lënë pas recesionin ekonomik të vitit 2020, prej -4%. Ndërsa, për vitin 2022 Qeveria parashikon një rritje të ekonomisë me 4.1% duke mbajtur një nivel mesatar prej mbi 4% për vitet pasuese 2023 dhe 2024. Rritja e rritjes ekonomike në këto nivele do të mundësojë mbështetjen e mëtejshme të qytetarëve duke rritur mirëqenien e tyre.

Për vitin 2022 parashikohet një ulje të normës së papunësisë nga 11.4% në 2021 në nivelin 10.3%. Rritja ekonomike dhe punësimi do të mbështeten edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 6.4% e PBB-së ose 119.1 miliardë lekë duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 20 miliardë lekë si dhe transfertën kapitale për fondin e shpronësimeve me 1,8 miliardë lekë.

Deficiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5.4 për qind të PBB nga rreth 6.8 për qind i pritshëm për vitin 2021. Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do t’i rikthehet një

trajktore rënëse duke filluar që nga 2022, ku pritjet të bjerë në rreth 78.9 për qind të PBB nga rreth 80 për qind i pritshëm për këtë vit.

Projektbuxhetit i vitit 2022, është buxheti i mbështetjes financiare të mëtejshme të reformave të nisura në sektorët kyç të ekonomisë, si reforma në drejtësi, reforma e administratës publike dhe reforma e menaxhimit të financave publike. Është konsideruar buxhet i rritjes së pagave për dy sektorët më të rëndësishëm në vend: të shëndetësisë dhe të arsimit.

Në vitin 2022, të ardhurat totale të buxhetit janë planifikuar të arrijnë në 536.8 miliardë lekë, krahasuar me të pritshmin e vitit 2021, të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit për vitin 2022 parashikohen të rriten me 7.8%. 93 % të të ardhurave të planifikuara për tu mbledhur deri në fund të vitit 2022 janë nga zëri i të ardhurave tatimore të cilat planifikohen në vlerën 500.1 miliardë lekë dhe kryesisht të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat që planifikohen të jenë për vitin 2022 në vlerën 360.5 miliardë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore planifikohen të jenë 112 miliardë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore synon finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, të cilat së bashku garantojnë stimuj pozitivë për rritjen ekonomike të vendit duke sjellë njëkohësisht rritje të punësimit. Për vitin 2022 shpenzimet e përgjithshme buxhetore janë programuar në nivelin e 637.6 miliardë lekë ose 34.1% e PBB. Shpenzimet e personelit për vitin 2022, janë planifikuar në masën 90.6 miliardë lekë, 14,2 % të shpenzimeve buxhetore ose 4.9% e PBB-së. Këto shpenzime reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave kryesisht për sektorët e shëndetësisë dhe arsimit dhe mbrojtjes me një rritje prej 6%.

#### **IV. REALIZIMI I REFORMAVE**

##### ***A. Reforma në Drejtësi***

Për reformën në drejtësi që prej vitit 2016 qeveria shqiptare ka shpenzuar 4,45 miliardë lekë. Ndërsa për vitin 2022 mbështetja buxhetore për të gjitha institucionet e drejtësisë është planifikuar të jetë rreth 8,4 miliard lekë. Rritjen më të madhe të shpenzimeve buxhetore në krahasim me vitin 2021, për institucionet e drejtësisë e ka SPAK me një rritje me 509 milion lekë ose me rreth 50% krahasuar me një vit më parë dhe KLGJ me një rritje me 186 milion lekë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë më pothuajse 7 milion lekë më shumë dhe Prokuroria e Përgjithshme 4,3 milion lekë më shumë.

Edhe objektivat e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën 2022-2024, janë orientuar drejt jetësimit të Reformës në Drejtësi për funksionalizimin e plotë të organeve të reja të drejtësisë si

dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi.

Rritje të shpenzimeve buxhetore është planifikuar dhe për një sërë institucionesh të tjera të pavarura. Kështu në projektbuxhet është parashikuar rritja e shpenzimeve buxhetore të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me 40 milion lekë më shumë se në 2021 dhe Avokatit të Popullit me 7 milion lekë më shumë se në 2021.

### ***B. Reforma administrativo-territoriale***

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë dhe reformat e ndërmarra deri më tani pritet të kenë ndikimin më të madh në organizimin e administratës publike vendore në funksion të rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore.

Niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 do të jetë rreth 250 milionë lekë më i lartë se viti 2021. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2022, që planifikohet në vlerën 18.7 miliardë lekë, do të shtohen edhe fondet prej 8.75 miliardë lekë transferte e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, transferuar në nivel vendor, si rrjedhojë, në vitin 2022, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 27.45 miliard lekë.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2021 do të jenë 27.6 miliardë lekë ose 6 për qind më të larta se sa i pritshmi i vitit 2021 dhe po thuajse mbi dy herë më të larta se ato të viteve 2013 dhe 2015.

Në vijim të procesit efektiv të decentralizimit, vend të rëndësishëm zënë vazhdimi dhe konsolidimi i reformës së financimit të arsimit parashkollor. Përmes buxhetit të vitit 2022, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim konsolidimin e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

## **V. DISKUTIME NË KOMISION**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” u prezantua në Komisionin nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë. Në fjalën e saj, Ministrja bëri një përmbledhje të parametrave të përgjithshëm të ekonomisë shqiptare, masave të projektuara për vitin 2022 nga qeveria për biznesin dhe qytetarët, si dhe një panoramë të përgjithshme të drejtimit kryesorë ku do të fokusohet buxheti vitin e ardhshëm.

Ministrja theksoi faktin se, pavarësisht ndikimit në ekonomi që pati tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia COVID 19, politikat që do ndiqen në vitin 2022 do materializohen në rritje ekonomike, rritje të punësisimit dhe të tregtisë, si dhe rritje të konsumit dhe investimeve private.

Relatori i këtij projektligji z.Alqi Bllako pasi bëri një ekspozitë të përgjithshme të projektligjit përpara i takon përbushjes së objektivave madhorë të rimëkëmbjes ekonomike dhe sigurimit të stabilitetit të financave publike, vlerësoi se zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore janë planifikuar në mënyrë rigoroze dhe realiste, si dhe duke u mbështetur në një nivel të lartë investimesh publike, përqendruar në procesin e rindërtimit si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike.

Relatori gjatë fjalës së tij u ndal veçanërisht në:

- mbështetjen e vazhdueshme buxhetore që Qeveria ka akorduar për reformën në drejtësi nëpërmjet të cilës do të rritet besimi i publikut për sistemin e drejtësisë, do të mbështetet zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik i vendit si dhe do të mundësohet integrimin në familjen evropiane dhe
- reformat e ndërmarra për njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe rritja e konsiderueshme e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, që kanë bërë të mundur që të rriten mbi tre herë investimet dhe shërbimet publike për këto njësi.

Anëtarët e Komisionit i drejtuan pyetje të ndryshme si dhe kërkuan informacione të hollësishme nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë lidhur me parashikimet në buxhetin e vitit të ardhëm për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë dhe ish pronarëve, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale dhe sistemin e ndihmës juridike falas që çdo qytetar në pamundësi financiare dhe grupet në nevojë, reformimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit, zbatimin e kontratave koncesionare PPP dhe fondet e akorduara në buxhetin e 2022, etj.

Ministrja dhe përfaqësuesit e tjerë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë iu përgjigjën pyetjeve duke shpjeguar se në projektligj janë parashikuar:

- Shpenzimet për Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve, në projektbuxhet parashikohen në total në masën 5 miliardë lekë ose 0.3% e PBB-së, ndërsa për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliardë lekë ose 0.1% e PBB-së.
- Ofrimi i ndihmës juridike falas për 5060 individë dhe 3036 gra e vajza në nevojë, që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas.
- Rritjen e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.
- Përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar dhe uljen e mbipopullimit në burgje, sigurimin e kushteve të përshtatshme të rreth 5100 të dënuarve burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtimin me shërbim shëndetësor 382 të dënuar të sëmurë.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përfundim të diskutimeve vendosi të miratojë në parim projektligjin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, duke konstatuar se:

- Në **aspektin ligjor**, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi,
- Në **aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Përfaqësuesit e opozitës të pranishëm në mbledhjen e komisionit votuan kundër projektligjit.

Komisioni i Ligjeve, në përputhje me nenet 79 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit dhe afateve të përcaktuara Kalendarin e Kuvendit “Për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022””, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

**RELATORË**

**KRYETARE**

**Alqi BLLAKO**

**Klotilda BUSHKA**

**Klevis XHOXHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Tiranë më 18.11.2022

Dokument Parlamentar

**RAPORT**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

*(Shqyrtimi nen për nen)*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjet e datave 5, 8, 9, 11 dhe 18 nëntor 2022, bëri prezantimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2022” dhe zhvilloi seanca dëgjimore me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e pavarura të krijuara me ligj, sipas fushës së veprimtarisë, në përgjegjësinë e këtij Komisioni, konkretisht me:

1. *Gjykatën Kushtetuese;*
2. *Prokurorinë e Përgjithshme;*
3. *Shkollën e Magjistraturës;*
4. *Këshillin e Lartë Gjyqësor;*
5. *Këshillin e Lartë të Prokurorisë;*
6. *Inspektorin e Lartë të Drejtësisë;*
7. *Strukturën e Posaçme Anti Korrupsion;*
8. *Kolegjin e Posaçëm të Apelimit;*
9. *Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;*
10. *Institucionin e Komisionerëve Publikë;*
11. *Institucionin e Presidentit;*
12. *Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;*

13. *Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;*
14. *Avokatin e Popullit;*
15. *Komisionin e Prokurimit Publik;*
16. *Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;*
17. *Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
18. *Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;*
19. *Autoritetin Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;*
20. *Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit;*
21. *Ministrinë e Drejtësisë;*
22. *Shoqatat përfaqësuese të njësive të vetqeverisjes vendore.*

Pas prezantimeve të kërkesave buxhetore nga titullarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të pavarura të krijuara me ligj, Komisioni konstatoi se:

### **1. Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Gjykatën Kushtetuese është rreth 156,8 milion lekë, nga të cilat:

- 125 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 27,3 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 0,5 milion nga zëri i transfertës së huaj;
- 4 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 1,8 milionë lekë, ndërsa nuk kanë ndryshuar shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe shpenzimet për investime.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Sekretari i Përgjithëm i Gjykatës Kushtetuese z. Eugen Papandile, i cili për projektbuxhetin e vitit 2022 kërkoi që të merren parasysh kërkesat e mëposhtme:

- Shtesë e numrit të punonjësve me 10 punonjës më shumë, me një llogaritje shtese në fondin e pagave dhe sigurime shoqërore e shëndetësore në vlerë 28,5 milion lekë;
- Shtesë në zërin e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 37,8 milion lekë për përmbushjen e plotë të nevojave të institucionit;
- Shtesë në zërin e shpenzimeve kapitale në vlerën 20 milion lekë që do shërbejë dhe për rikonstruksionin e ambienteve të brendshme të gjykatës, etj.

***Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesën në zërin e shpenzimeve kapitale në vlerën 15 milion lekë, nga të cilat 5 milion***



*lekë për financimin e projektit të digjitalizimit të arkivës së institucionit dhe 10 milion lekë për rikonstrukcionin e godinës.*

## **2. Për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Prokurorinë e Përgjithshme është rreth 2 424 milion lekë, nga të cilat:

- 1914,6 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 379,4 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 130 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se për Prokurorinë e Përgjithshme janë rritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 44,6 milion lekë, janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 9,5 milion lekë dhe janë ulur investimet me 50 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme, i cili u shpreh se buxheti i planifikuar për vitin e ardhshëm plotëson më së miri të gjitha nevojat e institucionit.

*Në përfundim të diskutimeve, Komisioni duke patur parasysh se fondet e akorduara për këtë institucion mund të përballojnë dhe shtesën e 20 punonjësve OPGJ të planifikuar për vitet 2023 dhe 2024 vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesën për 20 punonjës më shumë në vitin 2022.*

## **3. Për projektbuxhetin e Shkollës së Magjistraturës**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Shkollën e Magjistraturës është rreth 305,6 milion lekë, nga të cilat:

- 70,4 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 53,7 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 173,5 milion lekë tranferta për përballimin e bursave;
- 8 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se për Shkollën e Magjistraturës janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 1,2 milion lekë dhe është rritur transferta për individët për përballimin e bursave të magjistratëve me 48,9 milion lekë, ndërsa investimet janë ulur me 52 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës z. Arben Rakipi, i cili për projektbuxhetin e vitit 2022 për këtë institucion kërkoi që të merret parasysh:

- Mundësia e rishikimit të zërit të shpenzimeve operative në fazën e ndryshimeve buxhetore në muajin qershor. Kërkesat për rritjen e këtij zëri lidhen me shpenzimet për pagat e ekspertëve dhe pedagogëve të programeve formuese të Shkollës të cilat nuk mund të parashikohen saktësisht në këto momente por në një afat të mëvonshëm.
- Shtimin e fondeve në zërin e transfertës për numrin e kandidatëve që pritet të pranohen sipas kërkesave të Sistemit të Drejtësisë. Edhe kjo kërkesë është për fazën e rishimit të buxhetit në qershor.
- Rritjen e zërit të shpenzimeve kapitale me 60 milion lekë për investimet në pajisje elektronike, blerje librash, etj.
- Rritjen e zërit të shpenzimeve kapitale me 576 milion lekë për ndërtimin e godinës së re të Shkollës.

*Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi ti kërkojë komisionit përgjegjës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që të mbajnë në konsideratë kërkesat e Shkollës për rishimin e buxhetit në qershor të vitit 2022, për akomodimin e të gjitha nevojave që lidhen me pagesat e pagave të ekspertëve dhe pedagogëve të programeve formuese të Shkollës si dhe të zërit të transfertës për buxhet familjare dhe individët.*

*Gjithashtu, Komisioni kërkon që të planifikohen edhe fondet e nevojshme në zërin e investimeve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit në masën 576 milion lekë, që do të përdoren për ndërtimin e godinës së Shkollës.*

#### **4. Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Këshillin e Lartë Gjyqësor është rreth 3629,8 milion lekë, nga të cilat:

- 2805,3 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 563,4 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 6,1 milion lekë tranferta për individët;
- 282 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se për KLGJ-në janë rritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 58,3 milion lekë, janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 66.2 milion lekë dhe janë rritur investimet me 82 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Naureda Llagami. Përfaqësuesit e KLGJ-së gjatë prezantimit të

projektbuxhetit të vitit 2022 si organ qeverisës i sistemit gjyqësor, vlerësuan rritjen e zërave të vecantë të buxhetit. Edhe pse parimisht dakord me projektbugjetin përfaqësuesit e institucionit kërkuan që Komisioni të marrë parasysh një shtesë prej 1 miliard lekësh të ndarë në zëra si më poshtë:

- rritjen e zërit të pagave dhe kontributeve me 30 milion e 382 mijë lekë për një numër punonjësish prej 27 vetë, si pasojë e përfundimit të mandatit të KPK-së.
- rritjen e shpenzimeve për investime, sipas kërkesave të mëposhtme:
  - ✓ 84 milion për kryerjen e projektit të zbatimit të 4 gjykatave.
  - ✓ 153 milion për ndërtimin e gjykatave të Durrësit e Fierit
  - ✓ 116 milion lekë për projektin e digjitalizimit të dosjeve të arkivit gjyqësor.
  - ✓ 36 milion lekë për projektin për mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik.

*Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesat e mëposhtme në zërin e investimeve:*

- *financimin e hartimit të projekt zbatimit për ndërtimin e Gjykatës së Lartë në vlerën 29 milion lekë.*
- *financimin e hartimit të projekt zbatimit për ndërtimin e Gjykatës së Tiranës në vlerën 38 mln Lekë*
- *financimin e sistemit të ri elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore në vlerën 100 milion lekë vetëm për 2022. Vlera totale e projektit 443 milion lekë.*

#### **5. Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë është rreth 158,8 milion lekë, nga të cilat:

- 119,9 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 30,9 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 8 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se për këtë institucion janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 3,8 milion lekë, ndërsa investimet janë ulur me 9 milion lekë.

*Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, anëtari i këtij Këshilli z. Alfred Balla nuk parashtrroi kërkesa për shtesa të tjera mbi fondet e akorduara.*

#### **6. Për projektbuxhetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për KPA-në është rreth 141,4 milion lekë, nga të cilat:

- 115,4 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 24 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;

- 2 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se buxheti i këtij institucioni ka pësuar një pakësim të fondeve në vlerën totale prej 15,6 milion lekësh.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, kërkesat buxhetore u parashtruan nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Albana Shtylla. Përfaqësuesit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë seancës dëgjimore në Komision paraqitën kërkesat për shtesa, si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kërkohet shtesa në vlerë prej 37,5 milion lekësh.
- Për shpenzimet për mallra dhe shërbime kërkohet shtesa në vlerën prej 24 milion lekësh.
- Për shpenzimet në investime kërkohet në vlerën prej 13,1 milion lekësh.
- Për shpenzimet e mirëmbajtjes së godinës dhe aktiveve të instaluar në të, Kolegji kërkoi të adresohet shtesa prej 2 milion lekësh në zërin e Ministrisë së Drejtësisë.

***Lidhur me kërkesat e paraqitura u vlerësua nga Komisioni që ti kërkohet Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:***

- ***Shtesa në vlerën prej 93 milion lekë në zërin paga dhe sigurime shoqërore pasi fondi i parashikuar është i pamjaftueshëm për mbulimin e plotë të nevojave të personelit.***
- ***Ndërkohë, u gjykua se shtesa e kërkuar për mirëmbajtjen e godinës akomodohet lehtësisht në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.***

## **7. Për projektbuxhetin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për KPK-në është rreth 204 milion lekë, nga të cilat:

- 164 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 38 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 2 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se buxheti për këtë insitucionon ka pësuar një ulje prej 32 milion lekësh, sidomos në zërin e pagave dhe shpenzimeve.

Prezantimi i projektbuxhetit për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, u parashtrua nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Pamela Qirko dhe përfaqësues të këtij institucioni. Përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë seancës dëgjimore në komision parashtruan kërkesën për:

- Shtesë në zërin e pagave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 54,682,000 lekë.
- Shtesë në zërin e investimeve në vlerën 3 milion lekë.

*Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesat e mëposhtme:*

- *Shtesën në zërin e pagave dhe kontributeve shoqërore në vlerën 54 682 mijë lekë, respektivisht 50 milion lekë shtesë në zërin 600 të pagave dhe shtesë 4 682 mijë lekë në zërin 601 të Kontributeve Shoqërore. Ky plotësim është i domosdoshëm për të garantuar funksionimin normal të këtij institucioni.*
- *Shtesën në zërin e investimeve në vlerën 3 milion lekë.*

## **8. Për projektbuxhetin e Institucionit të Komisionerëve Publikë**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për institucionin e Komisionerëve Publikë është rreth 75,5 milion lekë, nga të cilat:

- 66,1 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 7,4 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 2 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë rritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 9,1 milion lekë, janë ulur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 5,8 milion lekë si dhe janë ulur investimet me 2 milion lekë.

*Prezantimi i projektbuxhetit për institucionin e Komisionerëve Publikë u parashtrua nga Komisionerët z. Florjan Ballhysa dhe z. Dariel Sina. Komisionerët nuk parashtruan asnjë kërkesë për shtesa të fondeve buxhetore.*

## **9. Për projektbuxhetin e Inpektorit të Lartë të Drejtësisë**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë është rreth 266,8 milion lekë, nga të cilat:

- 180 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 21,6 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 1,2 milion lekë tranferta për individët
- 64 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë ulur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 6,4 milion lekë, ndërsa investimet janë rritur me 12 milion lekë.

*Duke marrë në konsideratë nevojat emergjente që ka buxheti, ILD vendosi të mos paraqesë asnjë kërkesë për shtesë fondesh buxhetore.*

#### **10. Për projektbuxhetin e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për SPAK është rreth 1008,8 milion lekë, nga të cilat:

- 880,7 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 108,1 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 20 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë ritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 500 milion lekë, janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 23.2 milion lekë, ndërsa investimet janë ulur me 10 milion lekë.

Në mbledhjen e Komisionit, për të prezantuar buxhetin e SPAK ishte i pranishëm z. Arben Kraja, i cili u shpreh parimisht dakord me projektbuxhetin e akorduar për këtë institucion, por për akomodimin e plotë të të gjitha nevojave paraqiti kërkesën për rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 20 milion lekë dhe të zërit të investimeve në vlerën 10 milion lekë.

*Në përfundim të diskutimeve për këtë institucion, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesat si në zërin e mallrave dhe shërbimeve në vlerën 20 milion lekë ashtu dhe për zërin e investimeve në vlerën 10 milion lekë.*

#### **11. Për projektbuxhetin e Institucionit të Presidencës**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Presidencën është rreth 249 milion lekë, nga të cilat:

- 122 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 121 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 6 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë ritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 700 mijë lekë dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime me 800 mijë lekë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, institucioni i Presidencës u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithëm znj. Ornela Zonja dhe këshilltari i Presidentit z. Petraq Milo, të cilët ishin parimisht dakord me projektbuxhetin e Institucionit të Presidencës, megjithatë ato paraqitën kërkesa shtesë mbi fondet e akorduara nga Ministria e Financave për financimin e projektit të digjitalizimit të arkivës së këtij institucioni me vlerë totale prej 36 milion lekësh.

*Komisioni, vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës shtesën e kërkuar prej 36 milion lekësh, të cilat do të shpërndahen në tre vitet në vijim, ku për 2022 shtesa në zërin e investimeve duhet të jetë 10 milion lekë.*

## **12. Për projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për ILDKPKI-në është rreth 195,9 milion lekë, nga të cilat:

- 126,3 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 36,4 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 0,2 milion lekë tranferta;
- 33 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë rritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 8 milion lekë, rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 1,3 milion lekë, është shtuar zëri i transfertës më 0,2 milion lekë si dhe janë rritur investimet me 30 milion lekë.

*Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, përfaqësuesit e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit nuk paraqitën kërkesa për fonde shtesë.*

## **13. Për projektbuxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për KQZ-në është rreth 186 milion lekë, nga të cilat:

- 112 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 32 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 40,5 milion lekë tranferta;
- 1,5 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 12,3 milion lekë dhe zëri i transfertës me 7,2 milion lekë, ndërsa investimet janë ulur me 15 milion lekë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, institucioni i KQZ-së u përfaqësua nga Kryekomisioneri z. Ilirjan Celibashi, i cili paraqiti kërkesat për shtesa, si më poshtë:

- shtesë fondi në vlerën 18.200.000 lekë në zërin “Shpenzime Kapitale” për “Shtesë kati për zgjerim hapësire”.
- shtesë fondi në vlerën 6.500.000 lekë në zërin “Shpenzime Kapitale“, për “Pajisje informatike dhe zyrash”.

- shtesë fondi në vlerën 139.480.000 lekë në zërin “Shpenzime Kapitale“, për “Rikonstrukcion i magazinës dhe dhomës së serverëve Magazina PEI”.
- shtesë fondi në vlerën 6.000.000 lekë në zërin “Shpenzime Kapitale“ për “Blerje automjetesh.
- shtesë fondi në vlerën 2.671.000 lekë në zërin “Shpenzime Kapitale“, për “Vënien në funksion të dhomës së serverëve të KQZ-së sipas parametrave optimal të standardeve të miratuara.
- shtesë fondi në vlerën 2.100.000 lekë në zërin “Shpenzime Kapitale“, për “Blerje pajisje për kopjimin e memorieve USB në paralel.
- Shtesë fondi në vlerën 8.845.460 lekë në zërin “Shpenzime Korrente” për “Hapjen e kutive të votimit”.

*Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e:*

- **Shtesë fondi në vlerën 150 751 mijë lekë në zërin “Shpenzime Kapitale“ për dhomën e serverave dhe magazinën e cila është e djegur, pajisje informatike dhe pajisje për kopjimin e memorjeve usb në paralel.**
- **Shtesë fondi në vlerën 8 845 mijë lekë në zërin “Shpenzime Korrente” për hapjen e kutive të votimit.**

#### **14. Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit:**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për KPA-në është rreth 141,4 milion lekë, nga të cilat:

- 115,4 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 24 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 2 milion lekë shpenzime për investime.

Në mbledhjen e Komisionit, institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua nga znj. Erinda Ballanca, e cila paraqiti kërkesat e mëposhtme:

- Shtimin e numrit të punonjësve me 2 punonjës shtesë dhe rritjen e zërit të pagave dhe shpenzimeve në vlerën 2 milion lekë.
- shtesën e zërit të investimeve 203 me 2 milion lekë, nëpërmjet rialokimit të kësaj vlere me pakësimin e zërit të mallrave dhe shpenzimeve 602 me një milion lekë dhe pakësimin e zërit të transfertës për buxhet familjar dhe individ 606 me një milion lekë.

*Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e kërkesës për shtimin e një punonjësi ndihmëskomisioner që do të reflektohet në rritje të fondit të pagave dhe rialokimin nga zëri i mallrave dhe shërbimeve dhe zëri i transfertës për tek zëri i investimeve në vlerën 2 milion lekë. Pra, komisioni do ti kërkojë komisionit përgjegjës:*



- *Shtësën në vlerën 3,946,108 lekë në zërin e shpenzimeve të personelit nga të cilat, 1 milion lekë do të pakësohet nga zëri i transfertës për buxhet familjar dhe do të shtohet tëk zëri i shpenzimeve të personelit ndërsa 2,946,108 lekë do të jenë shtesë buxheti në këtë zë buxhetor*
- *Shtësën në zërin e investimeve me 2 mln lekë nëpërmjet rialokimit të fondit nga zëri i shpenzimeve për mallra dhe shërbime i kësaj vlere tëk zëri i investimeve.*

#### **15. Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi është rreth 54,1 milion lekë, nga të cilat:

- 41 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 11,9 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 0,2 milion lekë tranferta;
- 1 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 1,4 milion lekë dhe janë ulur investimet me 3 milion lekë.

*Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, institucioni u përfaqësua nga Komisioneri z. Robert Gajda, i cili paraqiti kërkesën për rialokimin e fondeve nga zëri i shpenzimeve për mallra dhe shërbime në zërin e investimeve në vlerën 2 milion lekë. Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e kësaj kërkesë.*

#### **16. Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Komisionerin e të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është rreth 72,8 milion lekë, nga të cilat:

- 53,8 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 17,7 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 0,3 milion lekë tranferta;
- 1 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, buxheti rezulton me një ulje të fondeve totale në vlerën 5 milion lekë.

*Në seancën dëgjimore me këtë institucion, Komisioni u njoh me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi, i cili për shtesë në zërin e investimeve për realizimin e projektit të rregjistrimit elektronik*

*të thirrjeve të pakërkuara, me një vlerë totale prej 11 milion lekë. Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e kësaj kërkesë dhe akordimin e fondeve shtesë në zërin e investimeve për dy vitet në vijim, për vitin 2022 do të akordohen 5,5 milion lekë.*

#### **17. Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil është rreth 62,2 milion lekë, nga të cilat:

- 43,9 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 15,9 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 0,4 milion lekë tranferta;
- 2 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë rritur me 1,5 milion lekë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime me 0,9 milion lekë.

*Në mbledhjen e Komisionit, Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha, paraqiti kërkesë për shtimin e dy punonjësve në strukturën e këtij institucioni dhe fondet për shtesën në zërin e pagave do të sigurohen nëpërmjet rialokimit të tyre nga zëri i investimeve. Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e kësaj kërkesë.*

#### **18. Për projektbuxhetin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për AIDSSH-në është rreth 97,5 milion lekë, nga të cilat:

- 75 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 20,5 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 2 milion lekë shpenzime për investime.

*Në seancën dëgjimore të komisionit ishte prezent për të parashtruar kërkesat Kryetarja e Autoritetit znj. Gentiana Sula. Komisioni vendosi ti propozojë komisionit përgjegjës shtesën në zërin e investimeve nga të cilat për investimet me financim të huaj shtesa do të jetë 67,2 milion lekë, 10 milion lekë TVSH dhe 10,1 milion lekë shtesë në zërin investime për mobilim godine, ndërsa për shpenzimet për mallra dhe shërbime të shtohen 15 milion lekë. Gjithashtu, komisioni vendosi dhe për shtimin e zërit të pagave dhe kontributeve në vlerën 10 milion lekë.*

#### **19. Për projektbuxhetin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për ISKK-në është rreth 34 milion lekë, nga të cilat:

- 20 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 13 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 1 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se buxheti në tërësi është rritur me 1 milion lekë.

*Buxheti i ISKPK u paraqit në Komision nga z. Çelo Hoxha, Drejtor Ekzekutiv, i cili vlerësoi se fondet e akorduara për këtë institucion në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” akomodojnë nevojat për garantimin e funksionimit normal të këtij institucioni. Komisioni vendosi të propozojë komisionit përgjegjës shtesën në zërin e pagave dhe kontributeve në vlerën 5 milion lekë, si rregullim i pasaktësisë së bërë në llogaritjen e këtij fondi.*

## **20. Për projektbuxhetin e Komisionit të Prokurimit Publik**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për KPP-në është rreth 72 milion lekë, nga të cilat:

- 57,6 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 13,1 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 0,3 milion lekë transferta;
- 1 milion lekë shpenzime për investime.

*Buxheti i institucionit u prezantua në Komision nga Kryetari i KPP-së, z. Jonaid Myziri. Komisioni vendosi të miratojë kërkesën për rritje të shpenzimeve për investime me vlerën 24 milion lekë, për financimin e projektit të digjitalizimit të ankesave.*

## **21. Për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë**

Buxheti total i parashikuar për vitin 2022, për Ministrinë e Drejtësisë është rreth 11 miliard e 788 milion lekë, nga të cilat:

- 5 miliard e 376 milion lekë shpenzime për paga sigurime shoqërore;
- 1 miliard e 590 milion lekë shpenzime për mallra dhe shërbime;
- 4 miliardë e 242 milion lekë në zërin e transfertave
- 563 milion lekë shpenzime për investime.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2021, rezulton se janë:

- rritur shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me 379 milion lekë;
- rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime me 134 milion mijë lekë;
- rritur zërat e transfertës me 742 milion lekë
- investimet janë rritur me 20 milion lekë.

*Ministri i Drejtësisë, i pranishëm në seancën dëgjimore nuk paraqiti kërkesa shtesë mbi fondet e akorduara nga Ministria e Financave.*

## **22. Për Projektbuxhetin e Vendor**

Për vitin 2022, transfertat në buxhetin e njësisve të vetëqeverisjes vendore janë:

Transferta e pakushtëzuar e cila përbëhet nga:

- Pjesa e Përgjithshme prej 18.7 miliard lekë.
- Pjesa Sektoriale prej 8,75 miliard lekë.

Në seancën dëgjimore në komision, ishin të pranishëm përfaqësuesit e dy shoqatave vendore, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqatës për Autonomi vendore.

Përfaqësuesit e këtyre shoqatave kërkuan të merren në konsideratë kërkesat shtesë të cilat sipas tyre janë dhe në koherencë me politikat dhe objektivat e vetë qeverisë për:

- reformimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve;
- menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- menaxhimin e rreziqeve dhe emergjencave civile;
- zhvillimin e bashkive bregdetare turistike në përputhje me strategjinë e turizmit dhe
- parashikimin e fondit për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore transferuar bashkive nga ARRSH.

Konkretisht ata propozuan:

- Buxheti vendor për vitin 2022 të rritet nga 1% e PBB në 1,3% të PBB;
- Transferta sektoriale të rritet me 1,5 herë.
- Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore të shpërndahet në bazë të koeficientë në efektet dhe nivelin e prekshmërisë për bashki të vecanta si Shkodra, Lezha, Durrësi, Fieri dhe Vlora.
- Detyrimet e prapambetura vendore të mbarten nga qeveria qendrore duke filluar nga viti 2022.
- Ndarjen e të ardhurave nga renta minerare mes bashkitë dhe rritjen e përqindjes së përfitimit të pushtetit vendor deri në 50% në favor të bashkive
- Financimin e kostove shtesë në transportin urban nga qeveria qendrore me qëllim mos rendimin me kosto shtesë të qytetarëve si pasojë e rritjes së cmimit të biletës.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave referuar kërkesave të shoqatave vendore, informuan anëtarët e Komisionit se:

- **Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** do të jetë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore. Për vitin 2022 parashikohet të jetë në vlerën 2 miliard lekë, në

programin “Emergjencat Civile”, nga i cili një pjesë do të ndahet me formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive dhe pjesa tjetër do të ndahet në formën e grantit konkurrues, ku bashkitë do të aplikojnë me projekte bazuar në thirrjen për aplikim.

- **Menaxhimi i mbetjeve** në buxhetin e vitit 2022, është në vlerën 500 milion për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 200 milion për strukturën qendrore për pastrimin e plazheve. Ky fond do të shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbetjet urbane. Këshilli i Ministrave do të miratojë metodologjinë e financimit për mbetjet urbane nga pushteti qendror për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Mbështetur në këtë metodologji, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit me miratim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë bën shpërndarjen e fondit për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- **Stoku i detyrimeve të prapambetura** në fund të muajit qershor 2021, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është rreth 6.6 miliard lekë. Për këtë periudhë stoku i detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth 0.3 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të parë të vitit 2021, që ishte rreth 6.9 miliard lekë dhe me rreth 0.5 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2020, që ishte rreth 7.1 miliard lekë. Në vitin 2022 do të vazhdojë të monitorohet periodikisht zbatimi i planit të shlyerjes së detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në shlyerjen e plotë të tyre.
- Për rritjen e transfertës të të ardhurave nga **renta minerare** nga 5% në 50% diskutimet mes njërive të qeverisjes vendore dhe qeverisë vazhdojnë dhe nuk janë finalizuar.

Ndërkohë, Shoqata e Këshillave të Qarqeve ka propozuar parashikimin e një buxheti të dedikuar për këshillat vendor, përkatësisht këshillat bashkiakë i cili të përdoret në përmirësimin e infrastrukturës së këtyre këshillave. Ky propozim i përcillet komisionit përgjegjës të ekonomisë dhe financave për ta shqyrtuar dhe vlerësuar.

*Komisioni vendosi që ti propozojë komisionit përgjegjës miratimin e shtesës së kërkuar për akomodimin e të gjitha kërkesave të pushtetit vendor që lidhen me detyrime të përcaktuara në ligj sa i përket subvencioneve apo detyrimeve kontraktuale të angazhuara. Komisioni do dërgojë, bashkëlidhur këtij relacioni, në komisionin përgjegjës çdo kërkesë që ka ardhur nga Njësitë Vendore sa i përket detyrimeve të pa financuara.*

Në përfundim të seancave dëgjimore me të gjithë institucionet e sipërpërmendura, Komisioni në mbledhjen e datës 17 nëntor 2021 shqyrtoi dhe miratoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me ndryshimet e mëposhtme:

- **Neni 13, riformulohet si vijon:**

### **Neni 13**

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Metodologjia e llogaritjes së pagës mujore bruto për institucionet e sistemit të drejtësisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

- **Ndryshimet e miratuara nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për secilin institucion reflektohen në tabelën 1 të projektligjit “Buxheti 2020 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve të buxhetore”, si dhe në tabelën 2 që parashikon numrin e punonjësve për vitin 2022.**

**Raporti i përcillet për shqyrtim në përputhje me Rregulloren e Kuvendit Komisionit për Ekonominë dhe Financat.**

**RELATORË**

**KRYETARE**

**Alqi BLLAKO**

**Klotilda BUSHKA**

**Klevis XHOXHI**